



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 48
Prishtinë, më 21.10.2016, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Emilija Rexhepi, Salih Salihu, Shaip Muja dhe Time Kadrijaj.

Munguan: Murat Hoxha, Sergjan Popoviç, Haxhi Shala.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13.10.2016;
3. Shqyrtimi i çështjes së Hades, i ftuar ministri i MMPH-së dhe përfaqësuesi i Kabinetit të Kryeministrit;
4. Njoftimi nga MMPH-ja, rreth problemit të ndotjes së mjedisit në fshatin Mirosalë, Komuna Ferizaj;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Obiliqin;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për zhurmën;
7. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 13.10.2016

Procesverbali i mbledhjes dt.13.10.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i çështjes së Hades

Duda Balje, kryetare, përshëndeti dhe falënderoi të ftuarit nga MMPH-ja dhe Avokatin e Popullit, duke pyetur **ministrin Ferat Shala**, nëse kanë sugjerime, si duhet të përfundojë çështja e Hades. **Shaip Muja**, sugjeroi fillimisht ministrin, që për këtë çështje, në këtë takim të sotëm, propozimet të jenë më konstruktive. Shkurtimisht, nëse konstatojmë, vazhdoi ai, se në këtë fshat popullata nuk ka kushte për jetesë, e cila në tërësi është ngulfatur, si rrugëdalje ai e sheh dhënien e trojeve për t'i zhvendosur këta njerëz. **Ministri**, këtë periudhë të zhvendosjes së fshatit Hade, e ndau në dy faza: 2004-2011 dhe pastaj tjetra, deri më sot. Faza e parë, ka përfshirë Ligjin për shpronësime dhe shpalljen e zonës 2009, fusha e mihjes së re, mirëpo pasi që është konstatuar stagnimi është hartuar korniza, e miratuar nga Qeveria, në bashkëpunim me MMPH-në, Bankën Botërore, pra me parime bazë mjedisore dhe sociale, dhe në njëfarë mënyre, është zëvendësuar ligji. Ministri konstatoi se korniza është obliguese dhe parasheh që të shterret debati me komunitetin, gjithsesi duke paraparë edhe procesin e negocimit, por fillimisht ndërmarrja e KEK-ut duhet të sjellë planin e zhvendosjes. **Adem Salihaj**, ndërhyri me pyetjen: Çka nëse nuk e sjell, në fakt edhe nuk po e sjell, i cili plan do të miratohet në Qeveri? **Kryetarja**, gjithashtu, ndërhyri dhe apeloi për problemet shëndetësore, të cilat nuk presin dhe pohoi atë që konstatoi z. Salihaj, se të gjitha këto premtime të ministrit prolongohen. **Adem Salihaj**, vazhdoi me diskutimin, duke konstatuar se këtij fshati i është marrë e drejta për t'u zhvilluar. Pra, derisa Qeveria pret një plan nga KEK-u, kjo ndërmarrje thotë se janë duke hartuar procesin e fizibilitetit. Ai, edhe një herë parashtrroi pyetjen: Pse ky fshat ka mbetur në mes dhe është vazhduar me Shipitull? Kjo do të thotë se kjo popullatë i kanë ekskavatorët shumë afër dhe shumë procese tjera teknologjike që shkaktojnë zhurmën dhe jetën e padurueshme. Për këtë arsye, duhet urgjent të propozohet një zgjidhje. Këtu janë shkelur shumë të drejta njerëzore, vazhdoi ai, dhe aty nuk mund të jetohet më. **Salih Salihu**, gjithashtu, diskutoi në frymën e veprimit të domosdoshëm të Qeverisë, ngase mu në këtë fshat, 150 m ndër tokë, fillon qymyri i pastër. Gjërat nuk bën të fshihen. Gjithashtu, potencoi se në kornizë nuk e sheh që përmendet as Hade, as Obiliqi. **Time Kadrijaj**, pohoi atë që u dëgjua nga kolegët dhe tha se shënimet e ndryshme tregojnë se Obiliqi është një ndër rajonet më të ndotura në Evropë, me shkallë të lartë të sëmundjeve kancerogjene, ku numri i këtyre sëmundjeve është 30% më i lartë se në vendet tjera. **Emilija Rexhepi** ishte i mendimit që problemi është voluminoz,

prandaj duhet aplikohet zgjidhja hap pas hapi dhe fillimisht të lëshohemi në nivelin lokal. **Shaip Muja**, përsëriti kërkesën e ndarjes së trojeve dhe potencoi mungesën e qasjes praktike të problemit, përkundër vullnetit për zbatimin e kornizës aktuale. Avokati i Popullit, **Hilmi Jashari**, potencoi se Ligjin për shpronësime, të cekur nga ministri, i cili tani po u dashka të zëvendësohet me korniza të ndryshme apo diç të tillë, kjo në asnjë praktikë juridike, deri më tani nuk ka ndodhur dhe nuk bën të ndodhë, ngase asnjë akt nuk mund të zëvendësojë ligjin, sepse ligji është ai që duhet të obligojë. Po themi se korniza e zëvendëson ligjin, atëherë këtë kornizë duhet ta zbatojë Qeveria.

Ministri u përgjigj se mund të zbatohet korniza dhe duhet të zbatohet, por meqë ju jeni legjislati, sugjeroi që ta përfundojë Komisioni Ligjin për Obiliqin, me të cilin do të zgjidhet edhe problemi i Hades. Sa i përket shndërrimit të kornizës në ligj, ju këtë e keni në dorë, hartoni ligjin me 7-8 nene për zhvendosje dhe ja ku jemi, edhe ne jemi në situatë të keqe, përfundoi ai. Edhe **Arben Çitaku**, përsëriti aktet që janë në fuqi për këtë problematikë dhe nuk kundërshtoi idenë për troje, ngase KEK-ut kjo tokë i nevojitet. **Shaip Muja**, theksoi se çfarëdo ligji që bëhet, nuk largohet problemi, ngase KEK-u nuk dëshiron dhe ju nuk keni vullnet, ndërsa njerëzit jetojnë në fobi. Juve iu mbetet të merrni rolin e zjarrfikësit. Pra, me një vendim të Qeverisë, të ndani troje të lagjja e re dhe të largohet popullata nga jeta e padurueshme, kurse trojet që i kanë në Hade mos të shpronësohen njëherë. **Adem Salihaj**, pyeti: Çka nëse KEK-u nuk do?

Kryetarja Duda Balje, duke konstatuar se diskutimet vazhdojnë pa kufi në frymën si të veprohet. **Trojet, ligji apo zbatimi i politikës së zhvendosjes**, premtoi se kjo çështje do të përfundojë në mbledhjen e radhës së Komisionit.

4. Njoftimi nga MMPH, rreth problemit të ndotjes së mjedisit në fshatin Mirosalë, Komuna Ferizaj

Ministri **Ferat Shala**, rreth operatorit “Fito - Projekt” në Mirosalë të Ferizajt, menjëherë pas ankesës së banorëve, ka reaguar me Inspektoratin dhe ka obliguar këtë operator të aplikojë në MMPH, për pëlqim mjedisor, që edhe është përmbushur pajisja me këtë dokument, më 4.6.2014. Operatori në fjalë, ka bërë kohë pas kohe testimet provuese për vënien në funksion të këtij impianti. Po ashtu, kohë pas kohe kanë arritur ankesa nga komuniteti për kundërmimet, që vijnë nga ky impiant. MMPH-ja ka urdhëruar operatorin mos të vërë në funksion impiantin, derisa nuk plotësohen të gjitha kushtet teknike dhe të merret leja mjedisore. Operatori duhet të ketë lejen ndërtimore, për të marrë pastaj lejen mjedisore. Më 26.9.2016, pronari Fitim Ramadani, drejtohet në Departamentin për Mjedisin dhe Inspektoratin, që të prezantojnë për inspektim në procesin e pirolizës, që do të fillojë më 28.9.2016 dhe deklaroi se janë plotësuar kushtet teknike, që të lëshohet në punë impianti. Inspektorati ka kontaktuar nënkryetarin e Komunës së Ferizajt, i cili ka sugjeruar që biseda të bëhet personalisht me kryetarin, i cili më 4.10.2016, me ekipin e tij dhe të MMPH-së, është dakorduar që të angazhohet një kompani e certifikuar nga jashtë dhe t’i bëjë matjet gjatë punës së procesit të pirolizës. Këtë obligim e mori kryetari, në mënyrë që ky impiant, nëse lëshohet në punë, këto matje të krahasohen me vlerat e matura nga INKOS-i, dhe pas rezultateve nga këto matje, do të veprohet sipas legjislatit. **Adem Salihaj**, falënderoi për informatën dhe reagoi për analizat që do të bëhen nga operatorë të jashtëm, megjithatë pas reagimit të **Muhamet Malësiut**, që MMPH mbikëqyrë vetëm cilësinë e ajrit, ai reagoi se nga kjo fabrikë del diçka edhe në

ajër, ndaj **Salih Salihu** kërkoi që edhe matjet e ajrit të bëhen njëkohësisht, pra sa bëhet lirimi i gazrave etj. **Shaip Muja**, potencoi se tymi i bardhë nuk është shumë brengosës, sa duhet të jenë emisionet, të cilat janë më të rrezikshme.

Në ndërkohë, më 24 tetor ia ka dërguar një email stafit, z. Kenan Gashi, drejtor Ekzekutiv i Rrjetit të OJQ-ve “Avonet”, i cili njofton se në bashkëpunim me anëtarin e Komisionit Parlamentar të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, **z. Adem Salihaj**, të dielën, më 23 tetor 2016, nga ora 9:30 është vizituar lokaliteti në fshatin Mirosalë të Komunës së Ferizajt, e konkretisht fabrika “Fito-Projekt”, e cila, siç thuhet: **“Ishte duke kryer aktivitetin, që në këtë rast, kjo fabrikë punonte, edhe pse duke u bazuar edhe nga prezantimi në Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të u.d. të ministrit, z. Ferat Shala dhe sekretarit të Përgjithshëm z. Arben Citaku, që kësaj fabrike i është lëshuar vendimi për moszhvillim të punës. Andaj, në këtë rast dëshirojmë t’ju informojmë që kjo fabrikë ishte duke zhvilluar punën”**, përfundon njoftimi.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje

Stafi mbështetës i Komisionit.